



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 15
Prishtinë, më 17.12.2008 ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N.225

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Fatmire Berisha, Adem Hajdaraj, Donika Kadaj-Bujupi, Hestet Cakolli, Gani Buçinca dhe Mark Krasniqi.

Munguan: Enis Kervan, Memli Krasniqi dhe Dragan Dimiq

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Monitorimi i zbatimit të ligjeve,**
- 3. Të ndryshme.**

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

Në fillim të mbledhjes kryetari i Komisionit i dëshiroi mirëseardhje anëtarit të ri të Komisionit Gani Buçinca.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të datës 21.10.2008 me një korigjim teknik në diskutimin e anëtares së Komisionit Fatmire Berisha.

2. Monitorimi i zbatimit të ligjeve

Agim Veliu, kryetar lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se si Komision jemi të obliguar që përveq çështjeve të tjera të merremi edhe me çështjen e monitorimit të zbatimit të ligjeve që në fushat që i mbulon Komisioni.

Ne do duhej të debatojme se si ti qasemi çështjes së monitorimit të ligjeve, të formojmë grupe punuese për ligje të caktuara apo bashkarisht si Komision të merremi me këtë çështje.

Në vijim diskutuan anëtarët e Komisionit.

Heset Cakolli mendon se si Komision do duhej të organizohemi për monitorim të ligjeve në praktikë me qëllim të marrjes së informatave në terren për zbatimin e tyre.

Si shembull përmendi Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Vendimin e Qeverisë për ndërprerjen e studimeve për vitin akademik 2008/2009. Formimi i grupeve punuese nga vet Komisioni me qëllim të rishikimit të reformave në arsimin e lartë do të shërbente në marrjen e informatave lidhur me fazën e dytë të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë..

Me këtë rast tha se vizitat edhe në vendet në rajon do të na ndihmonin për marrjen e informatave lidhur me zbatimin dhe funksionimin e ligjeve në rajon.

Donika Kadaj - Bujupi kërkoi sqarim lidhur me shkurtesat të cilat janë prezantuar nga Qeveria lidhur me planin strategjik për vitin 2008.

Sa i përket monitorimit të ligjeve ajo kërkoi të sigurohet lista e ligjeve të miratuara me qëllim që Komisioni të përcaktohet se për cilat ligje do të fillon procesin e monitorimit.

Më tej kërkoi nga anëtarët e Komisionit të përcaktohet një anëtarë që do tjetë person kontaktues lidhur me çështjen e ndihmës apo përkrahjes nga ana e Organizatave si NDI OSBE të cilat do të mbështetnin Komisionin në realizimin e vizitave jashtë vendit.

Komisioni vlerësoi se këtë post të personit kontaktues me Organizatat e huaja ta ushtroi anëtarja Donika Kadaj.

Drita Kadriu i njoftoi anëtarët e Komisionit se ka filluar përgatitjen e një projekt plani të veprimit me qëllim të koordinimit të punëve të Komisionit, ku në mes tjerash ka paraparë edhe çështjen e monitorimit të ligjeve të miratuara. Ky projekt plan do të shqyrtohet nga Komisioni në mbledhjen e ardhshme.

Në kuadër të monitorimit të ligjeve parasheh edhe vizitat e Komisionit në njerat nga vendet e rajonit me qëllim të marrjes së informatave për implementim të ligjeve.

Gani Buçinca në diskutimin e tij përkrahi iniciativen e Komisionit në aspektin e monitorimit të ligjeve të miratuara nga kjo veprimtari. Në këtë kuadër ai përmendi Ligjin e Arsimit Fillor dhe të Mesëm, Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Ligjin për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës të cilat kanë hasur në vështirësi në zbatimin e tyre në praktikë.

Më tej ai theksoi se duhet kërkuar informatë se sa ka bërë ministria në aspektin e shkencës dhe hulumtimeve shkencore sa ndahen mjetet për këtë çështje, si dhe duhet bërë trysni pozitive për zhvillimin e kulturës dhe të sportit.

Adem Hajdaraj mendon se Universiteti ka kontribuar në botimin e teksteve origjinale bazike si dhe në përkthimin e tyre në këtë aspekt mendon se ka mjete dhe do të kontribuojë edhe në të ardhmen për studentët.

Sa i përket Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës si dhe Institutit Albanologjik ai mendon se këto Institucione janë duke punuar me përkushtim të duhur.

3. Të ndryshme

Kërkesa nga Asociacioni i të diplomuarve në IPAL do të shqyrtohet në mbledhjen e ardhshme të Komisionit.

Mbledhja e ardhshme e Komisionit do të mbahet të martën më 23.12.2008 duke filluar nga ora 11,00 ku do të debatohet lidhur me monitorimin e ligjeve të miratuara nga fushëveprimtaria e Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 11,50

Kryetari i Komisionit,

Agim VELIU